



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS**  
**Praktikë Përkthimi (A-B B-A) II**

**Ngarkesa:** 4 kredite, 40 orë seminare

**Viti / Semestri :** Viti III , semestri II;

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor në ‘‘Studime Britanike dhe Amerikane’’

**Kodi i lëndës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

*Objektivat e përgjithshme lëndore:*Të pajisë studentët me bazat teorike dhe praktike të përkthimit me gojë, përmes zbërthimit të thelluar të teksteve.Të zhvillojë aftësitë e studentëve në analizën gjuhësore të teksteve, duke përfshirë aspektet gramatikore, leksikore dhe stilistike në kontekst funksional.Të nxisë përdorimin e dijeve ndërdisiplinore (stilistikë, leksikologji, gramatikë) për të përmirësuar interpretimin dhe përkthimin me gojë.

*Objektivat specifike lëndore :*

- 1.Të aftësojë studentët në identifikimin e niveleve të tekstit për zbërthim në kontekstin e përkthimit me gojë.
- 2.Të njohë studentët me teknikat dhe strategjitë bazë të përkthimit dhe interpretimit në situata reale.
- 3.Të mësojë studentët të ndërthurin njohuritë nga fusha të ndryshme gjuhësore në mënyrë funksionale gjatë procesit të përkthimit.

*Rezultatet e pritshme:*

- 1.Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë dhe zbërthejnë tekste në funksion të përkthimit konsekuativ.
- 2.Do të përdorin teknika përkatëse për interpretim dhe do t'i përshtatin ato sipas stilit funksional të tekstit.
- 3.Do të demonstrojnë zotërim të njohurive ndërdisiplinore për të përballuar sfidat gjuhësore dhe kulturore në përkthimin me gojë.